



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI I MBROJTJES SË KONSUMATORËVE**

---

**VENDIM**

**Nr. 28, Datë 06.05.2013**

Komisioni i Mbrojtjes së Konsumatorëve me pjesëmarrjen e:

- |                            |            |
|----------------------------|------------|
| - Znj. Anila Jani          | Kryetare   |
| - Z. Gerdjan Xhanari       | Nënkryetar |
| - Z. Zamir Mocka (Stefani) | Anëtar     |

Në mbledhjen e tij të datës 06.05.2013, vazhdoi shqyrtimin e ankesës me nr. prot 69 date 11.12.2012, ardhur nga një grup ish-studentësh të Universitetit Jo Publik “Vitrina”, në lidhje me: çregjistrimin nga Universiteti “Vitrina”, si dhe sigurimin e listës së programeve mësimore kundrejt pagesës të caktuar nga universiteti, të paparashikuar në kontratën e lidhur ndërmjet këtyre palëve.

Komisioni pas shqyrtimit të ankesës së sipërpërmendur,

**VËREN SE:**

Komisioni i Mbrojtjes së Konsumatorëve ka filluar shqyrtimin e ankesës kundrejt Universitetit Vitrina në mbledhjen e datës 21.12.2012. Për vlerësimin e plotë të kësaj çështjeje, Komisioni i ka kërkuar Universitetit Vitrina, nëpërmjet shkresës me nr. Prot. 69/1, datë 26.12.2012, informacion në lidhje me problematiken e ngritur, kopje të kontratave origjinale të lidhur midis Universitetit “Vitrina” dhe studentëve ankues si dhe kopje për të gjitha llojet e kontratave standarde (tip) të përdorura nga Universiteti Vitrina prej vitit 2010.

Në mbledhjen e datës 05.02.2013, Komisioni ka dëgjuar përfaqësuesit e studenteve që kanë paraqitur ankesën. Studentet kanë shpjeguar se, në kontratën e tyre, të lidhur me Universitetin Vitrina, nuk ka pasur, në asnjë pike të saj, përcaktimin e ndonjë tarife në rast të çregjistrimit nga ky Universitet apo pagesa për sigurimin e listës së programeve mësimore. Studentet dëshmuar se janë vene përpara detyrimit për pagesën e tarifës së çregjistrimit si dhe pagesave të tjera, në lidhje me listën e programeve mësimore, vetëm pas kërkesës së tyre për t'u çregjistruar. Komisioni administroi si provë mandat pagesën prej 780 euro dhe kontratën me këtë universitet të studentes Elvana Pashkaj.

Gjithashtu, Komisioni ka konstatuar mungesën e përgjigjes zyrtare nga Universiteti Vitrina dhe gjobitjen e tij me shumën 300.000 leke për shkelje të Nenit 52/1 të Ligjit “Për mbrojtjen e konsumatorëve”, i ndryshuar, nëpërmjet Vendimit nr. 27, date 05.02.2013.

Me shkresën nr. 69/2, date 6.02.2013 Universitetit Vitrina i është përcjellë ky vendim, si dhe i është njoftuar vazhdimi i shqyrtimit të kësaj çështje, duke ftuar gjithashtu përfaqësuesit e Universitetit në një seancën dëgjimore.

Komisioni konstatoi se, në mbledhjen e datës 14.02.2013, u mbajt seanca dëgjimore me përfaqësuesit e Universitetit Vitrina, të cilët nuk u shprehën mbi përfshirjen e tarifave të çregjistrimit në kontratat me studentët ankues dhe i kërkuan Komisionit që, Universitetit Vitrina ti jepej më tepër kohë për tu përgjigjur me shkrim në rruge zyrtare.

Me shkresën nr. 70/3, date 22.02.2012, Komisioni i kërkoi përsëri Universitetit Vitrina që brenda një periudhe dy javore të dërgonte një informacion në lidhje me problematikën, kopje të kontratave origjinale të lidhur midis Universitetit “Vitrina” me studentët ankues dhe të kontratave tip/standarde të përdorura nga Universiteti Vitrina, prej momentit të licencimit e në vijim.

Në përgjigje të kësaj kërkesë, Universiteti Vitrina ka dërguar përgjigje zyrtare me ane të shkresës nr. 125/2, date 04.03.2013.

Komisioni, pasi ka shqyrtuar çështjen në tërësi dhe ka dëgjuar Universitetin Vitrina, vlerëson se:

Kontrata e lidhur ndërmjet Universiteti “Vitrina” dhe studentëve nuk parashikon, në asnjë nen apo pikë të saj, ndonjë tarifë për çregjistrim, për listen e programeve mesimore apo për ndonjë dokument tjetër. Detyrimi për pagesa tarifash të lartpërmendura i janë bërë me dije studentëve vetëm në momentin e kërkesës së tyre për t’u rregjistruar nga Universiteti Vitrina. Komisioni vlerësoi se kjo është praktike që bie në kundërshtim me nenin 33/1 të Ligjit nr.9902, dt.17.04.2008 “Për mbrojtjen e konsumatorëve”, i ndryshuar, sipas të cilit:

*“Tregtari i ofron konsumatorit shërbime në përputhje me kushtet e kontratës. Tregtari është përgjegjës për mospërputhjet e shërbimit të siguruar konsumatorit me kushtet e kësaj kontrate.”*

Në rastin konkret, praktika e ndjekur nga Universitetit Vitrina, bie në kundërshtim me dispozitën e lartpërmendur pasi ky Universitet ka pasur detyrimin ligjor që, nëse kërkonte kryerjen e një pagese për çregjistrim, ta parashikonte atë në kontratë dhe ta përcaktonte atë saktësisht, në mënyrë që konsumatori të ketë dijeni të plotë lidhur me këtë kusht që në momentin e nënshkrimit të kontratës.

Kërkesat e Universitetit Vitrina për të paguar shuma të tjera në rast çregjistrimi përbën një ndryshim të kushteve të kontratës që kërkon domosdoshmërisht miratimin edhe të palës tjetër kontraktuese të cilës i preken në mënyrë të drejtpërdrejtë interesat. Kjo është parashikuar dhe në vetë kontratën e lidhur ndërmjet Universitetit Vitrina dhe studentëve, pikërisht në nenin 7/3 të saj ku parashikohet se: «*Tarifat e përcaktuara dhe e papaguar akoma sipas kësaj kontrate, në përputhje me politikën tregtare të universitetit, mund të ndryshohen në marrëveshje të palëve kontraktore.*»

Në shkresën nr. 125/2, date 04.03.2013, Universiteti Vitrina shprehet se në bazë të nenit 5.3 të Kontratës së Shërbimit të nënshkruar midis palëve, “*studenti merr përsipër të zbatojë e rregulloren e brendshme të universitetit*”.

Komisioni gjykoi se, këto detyrime mund të përcaktohen vetëm në kushtet kontraktuale dhe nuk mund të zgjerohen apo të ndryshohen me akte të tjera që janë pjesë e administrimit të brendshëm të Universitetit (rregullore, vendime), të cilat nuk kanë kurrësi fuqinë juridike të një marrëdhënie kontraktore të dyanshme. Sikurse përcaktohet edhe në shkronjën (d) pika 5, të VKM-së Nr. 156, datë 22.03.2001 “Për shkollat e larta jopublike në Republikën e Shqipërisë”, “**rregullorja e brendshme**”, përmban dispozitat e përgjithshme, strukturën organizative, format e organizimit të studimeve dhe të kontrollit të dijeve, diplomimit, të drejtat dhe detyrimet e studentit e të pedagogëve, standardet etike;”.

Gjithashtu, në bazë të Shtojcës 4 të Udhëzimit të Ministrit Nr. 11, datë 28.02.2011 “Për procedurat dhe dokumentacionin për hapjen e një institucioni privat të arsimit të lartë, programeve të studimit universitar në ciklin e parë dhe ciklin e dytë, programeve të studimeve jouniversitare, të natyrës profesionale si dhe procedurat për pezullimin dhe revokimin e licencës”, jepen kërkesat minimale që duhet të përmbajë kontrata ndërmjet Studentit dhe IAL-së. Referuar kritereve të përcaktuara në këtë shtojcë, tregohet se rregullimi i marrëdhënies juridiko-civile që lind midis palëve nuk mund të jetë objekt i rregullores së brendshme të një Universiteti Privat.

Për sa me sipër, në bazë të nenit 33/1 të ligjit 9902, datë 17.04.2008 “Për mbrojtjen e konsumatorëve” i ndryshuar, “Përputhshmëria kontraktuale e shërbimeve”, detyrimi i pagesës së shumës prej 500 euro, për çregjistrim nga Universiteti, dhe shuma të tjera në euro për marrjen e listës së programeve në këmbim të marrjes së çregjistrimit, është praktike në kundërshtim me dispozitën e lartpërmendur.

Kjo praktike i ka shkaktuar dëm ankimeses Elvana Pashkaj, e cila ka paguar shumën prej 780 euro, për të mundësuar çregjistrimin së bashku me listën e programeve.

Kjo praktike ka shkaktuar dëm tek studentet e tjerë ankues: Roxhensa Stafasani, Otljana Peza, Florant Shullazi, Ervis Këmbara, Demona Abas, Esmeralda Muçaj, Bledar Bala; Elida Luri; Mirian Alcani, Romina Veizaj, të cilët nuk kanë mundur të kryejnë në kohe çregjistrimin, sipas kërkesës së tyre, duke iu sjellë pengesa të paparishikueshme dhe duke iu humbur mundësinë për tu regjistruar në kohe në një Universitet tjetër.

Gjithashtu, sipas pikës 5 të nenit 57 të ligjit për mbrojtjen e konsumatorëve, përcaktohet se:

*“Kur komisioni në shqyrtimin e kundërvajtjes administrative konstaton shkaktim dëmi, si pasojë e kundërvajtjes administrative, pas përfundimit të shqyrtimit administrativ, vlerëson masën e dëmit dhe me një vendim të veçantë vendos për shpërblimin e dëmit.*

*Masa e shpërblimit si dhe pagesa për vlerësimin e dëmit i ngarkohen subjektit që ka kryer kundërvajtjen administrative”*

### **PËR KËTO ARSYE:**

Komisioni i Mbrojtjes së Konsumatorëve mbështetur në nenin 33/1; nenin 52, shkronjën (a) të nenit 55, pikën 5 të nenit 57, të Ligjit nr. 9902, datë 17.04.2008 “Për mbrojtjen e konsumatorëve”, i ndryshuar, si dhe në pikën 6 të VKM nr. 1444, datë 22.10.2008 “Për mënyrën e funksionimit të pagesës së anëtarëve të komisionit të mbrojtjes së konsumatorëve, si dhe përcaktimin e procedurave të vlerësimit të shkeljeve”.

## **VENDOSI:**

1. Universiteti Vitrina të ndaloje shkeljen, të marrë të gjitha masat për ndreqjen e shkeljes dhe mos përsëritjen e praktikave të tilla.
2. Universiteti Vitrina të dëmshpërblejë Elvana Pashkaj me shumën prej 780 Euro.
3. Universiteti Vitrina të marrë masa për çregjistrimin e të gjithë studentëve ankues dhe dhënien e çdo dokumenti tjetër të nevojshëm për çregjistrim, pa pagesë sipas kushteve të kontratës.
4. Universiteti Vitrina të njoftojë Komisionin e Mbrojtjes së Konsumatorëve për zbatimin e pikave 1, 2 dhe 3 të këtij vendimi, brenda 30 ditësh nga marrja e njoftimit të këtij Vendimi.

Kundër Vendimit të Komisionit të Mbrojtjes së Konsumatorit keni të drejtë të ankoheni në Gjykatë brenda 30 ditëve nga data e marrjes dijeni për vendimin.

**KRYETAR I KOMISIONIT**

**ANILA JANI**